

Periudhat ekuivalente		Baza ligjore
A	Periudha në të cilat nuk është punuar, por janë njohur si vjetërsi pune para datës 31.12.1993, sipas ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966, të ndryshuar	Nenet 46 dhe 47 të ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966
1	Kur punëtorët apo nëpunësit që ishin në marrëdhënie pune, kanë ndjekur kurse me shkëputje nga puna për kualifikim dhe specializim të mëtejshëm, ose për ngritje ideologjike	Urdhëresa nr. 5 e Këshillit të Ministrave
2	Kur punëtorët apo nëpunësit që ishin në marrëdhënie pune, kanë ndje kur kurset e organizuara nga Shkolla e Partisë "V. I. Lenin"	VKM nr. 33, datë 12.3.1979VKM nr. 32, datë 12.3.1979
3	Periudha gjatë së cilës personi ka kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak	
4	Periudha kur personi është trajtuar me të ardhura nga sigurimet shoqërore për sëmundje ose barrëlindje si dhe invaliditet të grupit të I dhe të II	
5	Periudhën e kaluar në punën shoqërore për ndërtimin dhe rindërtimin e vendit, në aksione të rëndësishme të drejtuara nga organizatat e ndryshme shoqërore, kur personi, që ka marrë pjesë në punë shoqërore, ka punuar për një periudhë jo më pak se një muaj	
6	Koha e qëndrimit pa punë të punëtorit ose e nëpunësit, që ka ndërprerë punën, për të ndjekur bashkëshortin, i cili transferohet me punë jashtë shtetit, ose në pikat kufitare, në territorin e të cilëve nuk mund të sistemoheshin në punë	
7	Periudha e kryerjes së studimeve në shkollën e lartë, me shkëputje nga puna për gruan, të cilës e drejta për pension i ka lindur nga data 01.09.2000 dhe deri më 31.12.2032	

B	Periudhat në të cilat nuk është punuar, pas datës 01.01.1994 sipas ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.	Pika 2/b, neni 58 i Ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993
1	Periudha e përfitimit të pagesës papunësisë	Neni 55 i ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993
2	Periudha e përfitimit të të ardhurave nga sigurimet shoqërore për sëmundje, aksidente në punë/sëmundje profesionale ose barrëlindje	
3	Periudha kur përfituesi ka përfituar pension invaliditeti të pjesshëm aktiv nga data 21.10.1998	Ligji nr. 8392, date 09.02.1998

C	Baza e vlerësuar për periudhat e sigurimit të njohura me ligje të vecanta dhe akte nënligjore	
1	Periudha përfitimit të pagesës kalimtare sipas ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996 "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit",	
2	Periudha e përfitimit të pagesës kalimtare dhe pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi sipas ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura,	
3	Periudha e trajtimit financiar sipas VKM nr. 225, date 29.05.1992 dhe vendimit nr. 7, date 10.01.1996 "Për trajtimin financiar të ushtarakëve që dalin në lirim nga zbatimi i reformës në strukturat e Forcave të Armatosura dhe periudhën e trajtimit me pagesë	
4	Periudha e përfitimit të trajtimit, sipas ligjit nr. 8685, datë 9.11.2000 "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë"	
5	Periudha e përfitimit të trajtimit, sipas ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004 "Për punonjësit që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake"	
6	Periudha për personat që u shërbejnë invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, për periudhën e trajtimit financiar për këtë qëllim	
7	Periudha gjatë së cilës personi ka kryer shërbimin e detyrueshëm pas datës 1.1.1994	
8	Periudha e trajtimit me pagesë papunësie për bashkëshortin/en e ushtarakut aktiv (oficer, nenoficer, ushtar me pagese/profesionist) nga data 14.05.2004	VKM Nr. 854, datë 17.12.2004
9	Periudha e vuajtjes së dënimit me heqje të lirisë, për kohën e vuajtjes së dënimit me internim si dënim penal plotësues, për kohën e vuajtjes së dënimit si i internuar për shkaqe politike	ligjit nr. 7514, datë 30.9.1991